



www.qbz.gov.al

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 41

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E hënë, 15 tetor 2018**

## PËRMBAJTJA

|                                                                                                     |                                                                                                                                                                             | Faqe |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Kërkesë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 5330, datë 10.10.2018 | Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “Al-An” sh.p.k.....                                                                                           | 3    |
| Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 950, datë 10.10.2018                            | Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor.....                                                                              | 4    |
| Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 957, datë 11.10.2018                            | Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Ministrisë së Brendshme, të Bashkisë Skrapar dhe të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë..... | 5    |



# KËRKESË

**Nr. 5330, datë 10.10.2018**

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR  
DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ  
SUBJEKTIT “AL-AN” SHPK**

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Qendër, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e dënimit nr. 1, datë 9.2.2017, me vlerë 1.000.000 lekë, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i

ISHMPUT-së, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, adresë e panjohur.

Sa më sipër, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Qendër, bën njoftimin publik të aktit të vendimit të dënimit administrativ, respektivisht për subjektin si më poshtë:

**“Al-An” sh.p.k.**

KRYEINSPEKTORI  
Armando Lamaj

  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT  
**INSPEKTORIATI SHTETËROR I MJEDISIT DHE PYJEVE**

Nr. Serie: **0003586**

**VENDIM  
PËR  
DËNIM ADMINISTRATIV**

Nr. 1, datë 09.02.2017.

Inspektorët e ISHMP-së, pas ushtrimit të kontrollit mbi veprimtarinë e personit fizik/juridik, "ALAN sh.p.k.", në mbështetje të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të pikës 1/n, të nenit 69, të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2015 "Për mbrojtjen e mjedisit", referuar shkëlqeve të pasqyruara në Proces - Verbalin e Konstatimit të Kundërvajtjeve Administrative me Nr. Serie 0003886, datë 09/02/2017, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative:

**VENDOSA:**

1. Të dënoj me Gjobë në vlerën : 1000.000 lekë ( një milion )
2. Të dënoj me "Paralajmërim", si dënim administrativ kryesor.  
Si dhe një ose disa nga dënimet plotësuese të mëposhtme:
3. Të pezullojë pjesërisht ose plotësisht aktivitetin: .....
4. Të sekuestrojë pajisjet, mjetet dhe lëndët e mëposhtme: .....
5. Të propozojë pezullimin apo revokimin e lejes mjedisore me nr. d. 13.10.01.3/03.12.13
6. Të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe t'i raportojë strukturës urdhëruese brenda datës .....

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim te Komisioni i Ankimit të ISHMP, brënda 10 ditëve nga njoftimi i tij. Gjyba të derdhet në çdo bankë që ka llogari të Thesarit për Ministrinë e Mjedisit, brenda afatit ligjor. Një kopje e mandat - pagesës i dorëzohet Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve. Me kalimin e afateve ligjore ekzekutimi i vendimit të dënimit me gjobë do të bëhet në mënyrë të detyrueshme, në zbatim të Ligjit Nr. 10297, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

Mora një kopje të vendimit, sot më datë \_\_\_\_\_  
(.....)

Inspektori i ISHMP  
Edmond Selimi  
(Emër, mbiemër, firmë)

Në respektim të procedurave ligjore të përcaktuara në Proces-Verbalin për KKA, vendimi mbahet në katër kopje.



## NJOFTIM

Nr. 950, datë 10.10.2018

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS  
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË  
DREJTORISË SË SHËRBIMIT PYJOR**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë,  
Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike,  
Drejtoria e Drejtimit të Pronës publike, në zbatim  
të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë  
29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës  
shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe  
procedurën e shitjes”, të ndryshuar, shpall për  
shitje si më poshtë:

**1. Në administrim të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor**

| Nr. | Emërtimi i objektit                                                                                                                   | Vendndodhja | Vlerat (në lekë)                                            |                 |                 |           | Sipërfaqja e përgjithshme (m <sup>2</sup> ) | Sipërfaqja nën objekt (m <sup>2</sup> ) |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|-------------------------------------------------------------|-----------------|-----------------|-----------|---------------------------------------------|-----------------------------------------|
|     |                                                                                                                                       |             | Vlera fillestare e shitjes (mjete kryesore + mjete xhiroje) | Mjetet kryesore | Mjetet e xhiros | Trualli   |                                             |                                         |
| 1   | 5 objekte: ndërtesë e degës teknike, magazinë qendër, kapononet e makinave, kapononet e makinave (Tojota) kaponon rrëshire (magazinë) | Dibër       | 19 219 738                                                  | 19 219 738      | 0               | 2 545 352 | 746                                         | 746                                     |

**Subjekti i shpronësuar i truallit**, mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë brenda afatit të publikimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë, se, që

nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të publikimit. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

**Shënim.** Publikimi bëhet për ish-pronarët e truallit të subjektit të shpronësuar Nazif Shulku.

**Afati i publikimit fillon në datën 15.10.2018 dhe mbaron në datën 13.11.2018.**



## NJOFTIM

Nr. 957, datë 11.10.2018

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS  
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË  
MINISTRISË SË BRENDSHME**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, kapitulli III, shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

**1. Në administrim të Ministrisë së Brendshme**

| Nr. | Emërtimi i objektit | Vendndodhja     | Vlerat (në lekë)                                      |                 |         | Sipërfaqja e përgjithshme (m <sup>2</sup> ) | Sipërfaqja nën objekt (m <sup>2</sup> ) | Zhvillimi i ankandit |       |       |
|-----|---------------------|-----------------|-------------------------------------------------------|-----------------|---------|---------------------------------------------|-----------------------------------------|----------------------|-------|-------|
|     |                     |                 | Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall) | Mjetet kryesore | Truall  |                                             |                                         | Data                 | Ora   | Vendi |
| 1   | Posta Kufitare      | Trebisht, Dibër | 3 717 989.9                                           | 3 353 669.9     | 364 320 | 3312                                        | 370                                     | 6.11.2018            | 13:00 | DDPP  |

**Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje me ankand,** duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

**Shënim.** Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

**Subjekti i shpronësuar i truallit,** mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare

në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave,** të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë,** prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale,** në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë, se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë, në llogaritë respektive të



hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: [www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

**NJOFTIM**  
**Nr. 957, datë 11.10.2018**

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS  
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË  
BASHKISË SKRAPAR DHE MINISTRISË  
SË BRENDSHME**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, kapitulli III, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

**1. Në administrim të Bashkisë Skrapar**

| Nr. | Emërtimi i objektit  | Vendndodhja    | Vlerat (në lekë)                                      |                 |        | Sipërfaqja e përgjithshme (m <sup>2</sup> ) | Sipërfaqja nën objekt (m <sup>2</sup> ) | Zhvillimi i ankandit |       |       |
|-----|----------------------|----------------|-------------------------------------------------------|-----------------|--------|---------------------------------------------|-----------------------------------------|----------------------|-------|-------|
|     |                      |                | Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall) | Mjetet kryesore | Truall |                                             |                                         | Data                 | Ora   | Vendi |
| 1   | Ish-Spitali i Vjetër | Potom, Skrapar | 401 297                                               | 369 149         | 32 148 | 183.7                                       | 183.7                                   | 6.11.2018            | 10:00 | DDPP  |

**2. Në administrim të Ministrisë së Brendshme**

| Nr. | Emërtimi i objektit                    | Vendndodhja        | Vlerat (në lekë)                                      |                 |         | Sipërfaqja e përgjithshme (m <sup>2</sup> ) | Sipërfaqja nën objekt (m <sup>2</sup> ) | Zhvillimi i ankandit |       |       |
|-----|----------------------------------------|--------------------|-------------------------------------------------------|-----------------|---------|---------------------------------------------|-----------------------------------------|----------------------|-------|-------|
|     |                                        |                    | Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall) | Mjetet kryesore | Truall  |                                             |                                         | Data                 | Ora   | Vendi |
| 1   | Objekte të postës së Policisë Kufitare | Peshkëpi, Pogradec | 9 828 480                                             | 9 300 480       | 528 000 | 2400                                        | 371.72                                  | 6.11.2018            | 11:00 | DDPP  |

**3. Në administrim të Bashkisë Skrapar**

| Nr. | Emërtimi i objektit   | Vendndodhja    | Vlerat (në lekë)                                      |                 |        | Sipërfaqja e përgjithshme (m <sup>2</sup> ) | Sipërfaqja nën objekt (m <sup>2</sup> ) | Zhvillimi i ankandit |       |       |
|-----|-----------------------|----------------|-------------------------------------------------------|-----------------|--------|---------------------------------------------|-----------------------------------------|----------------------|-------|-------|
|     |                       |                | Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall) | Mjetet kryesore | Truall |                                             |                                         | Data                 | Ora   | Vendi |
| 1   | Ish-magazinë e bimëve | Potom, Skrapar | 499 694                                               | 477 294         | 22 400 | 123                                         | 123                                     | 6.11.2018            | 12:00 | DDPP  |



Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare**, në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

**Shënim.** Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

**Subjekti i shpronësuar i truallit** mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë, se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë, në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe, faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: [www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)



## NJOFTIM

Nr. 957, datë 11.10.2018

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS  
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË  
INSTITUTIT TË PËRGATITJES SË  
QENVE TË POLICISË, TIRANË**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

**Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë**

| Nr. | Emërtimi    | Datëlindja | Vendndodhja | Vlera fillestare e ankandit në lekë | Zhvillimi i ankandit |       |       |
|-----|-------------|------------|-------------|-------------------------------------|----------------------|-------|-------|
|     |             |            |             |                                     | Data                 | Ora   | Vendi |
| 1   | Qeni Roko   | 7.5.2017   | Tiranë      | 15,000                              | 7.11.2018            | 09:00 | DDPP  |
| 2   | Qeni Izi    | 12.5.2017  | Tiranë      | 15,000                              | 7.11.2018            | 09:30 | DDPP  |
| 3   | Qeni Doli   | 23.9.2016  | Tiranë      | 15,000                              | 7.11.2018            | 10:00 | DDPP  |
| 4   | Qeni Iza    | 7.12.2009  | Tiranë      | 8,000                               | 7.11.2018            | 10:30 | DDPP  |
| 5   | Qeni Joga   | 29.5.2009  | Tiranë      | 8,000                               | 7.11.2018            | 11:00 | DDPP  |
| 6   | Qeni Bredhi | 2.11.2009  | Tiranë      | 8,000                               | 7.11.2018            | 11:30 | DDPP  |
| 7   | Qeni Kofi   | 20.11.2009 | Tiranë      | 8,000                               | 7.11.2018            | 12:00 | DDPP  |
| 8   | Qeni Bobi   | 1.11.2009  | Tiranë      | 8,000                               | 7.11.2018            | 12:30 | DDPP  |
| 9   | Qeni Aksi   | 10.10.2017 | Tiranë      | 15,000                              | 7.11.2018            | 13:00 | DDPP  |

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerje, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Garancinë bankare apo mandatpagesën në original, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën

shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe, faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë:

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

**Tiranë, 2018**